

VENDIM
Nr. 275, datë 1.4.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE RREGULLAT
E SIGURISË SË ARMËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 3, 16, pika 3, 17, pika 4, e 28, pika 4, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministratë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR KUSHTET DHE RREGULLAT E SIGURISË SË ARMËVE

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e:
 - a) kriterëve të sigurisë së armëve të zjarrit private, që mbahen nga subjektet e licencuara dhe të autorizuar për veprimtari të lejuara me armë;
 - b) kushteve të sigurisë që duhet të plotësohen për veprimtarinë e transportit të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre;
 - c) kushteve të sigurisë së objektit për ushtrimin e veprimtarisë së subjektit të tregtimit të armëve;
 - ç) kushteve të sigurisë për ndërtimin dhe funksionimin e poligonit civil të qitjes.
2. Rregullorja zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon përdorimin e kontrolluar të armëve në vendbanim dhe vendet e ruajtjes së armëve, përcakton kushtet që duhet të kenë poligonet civile të qitjes për zhvillimin e qitjeve e ushtrimeve praktike me armët, përcakton kushtet e sigurisë së objektit për ushtrimin e veprimtarisë së subjektit të tregtimit të armëve, si dhe kushtet që duhet të plotësohen për kryerjen e transportit të armëve.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

- a) “Kabllloja me çelës” (*cable lock*) nënkupton mjetin e vendosur në tytë dhe në folenë e krehrit për të parandaluar vendosjen e fishekut në tytë. Kabllloja përbëhet nga kavo sigurie çeliku i veshur me gome me diametër në skaj 8 mm dhe në skaje mbyllet me çelës.
- b) “Bllokuesi i këmbëzës” (*tigër lock*) nënkupton mjetin e vendosur mbi mbrojtësen e këmbëzës së shkrepjes për të penguar veprimin e këmbëzës së shkrepjes. Bllokuesi i këmbëzës përbëhet nga dy

pllaka metalike me trashësi jo më pak se 2 mm që vendosen nga të dyja anët e mbrojtjes së këmbëzës dhe mbyllen me çelës.

c) “Pesha neto e lëndës shpërthyesë” (*NEQ- net explosive quantity*) nënkupton vetëm peshën e lëndës plasëse jo peshën e municionit të unifikuar.

ç) “Person i autorizuar”, në kontekst të kësaj rregulloreje, nënkupton personin e lejuar për administrimin e municioneve.

Neni 3

Fusha e zbatimit, përcaktimi dhe vlerësimi i rrisqeve

1. Kjo rregullore zbatohet në veprimtaritë e lejuara me armët nga subjektet juridike dhe fizike në vendbanim, në vendet e ruajtjes së armëve, në poligone qitjeje, në mënyrë të tillë që arma të sigurohet për të hequr, për të shmangur mundësinë e përdorimit të tyre nga persona të paautorizuar.

2. Zbatohet nga gjitha subjektet që duan të ndërtojnë e të zhvillojnë biznes me poligonet civile të qitjes.

3. Zbatohet nga subjektet e licencuara për transport armësh, në mënyrë që të parandalohen ngjarje kriminale gjatë kësaj veprimtarie.

4. Kjo rregullore ju vjen në ndihmë jo vetëm subjekteve që do të kryejnë këto aktivitete, personave fizikë që do të mbajnë armë, që do të ndërtojnë poligone apo do të kryejnë transport armësh, por edhe strukturave të policisë që të inspektojnë masat e sigurisë në lidhje me mbajtjen, qitjen dhe transportin e armëve.

PJESA II

KUSHTET DHE KRITERET E SIGURISË SË ARMËVE

Neni 4

Kushtet e përgjithshme të ruajtjes për armët e zjarrit

1. Personat fizikë dhe juridikë të cilët zotërojnë armë zjarri të lejuara janë të detyruar që armën e zjarrit ta ruajnë, si në vijim:

a) Arma e zjarrit duhet të ruhet e zbrazët. Në çdo rast zbrazja bëhet jashtë vendit të banimit, ambientit të shitjes, dhomës së mbajtjes së armëve për subjektet e tjera;

b) Armët e zjarrit ruhen në kasafortë/dhoma për armë, të mbyllura me portë të blinduar, të jenë të betonuara ose të salduara duke i bërë të palëvizshme. Çelësat e dollapëve, kasafortave apo të dhomave për armët duhet të ruhen në vend të sigurt. Vetëm personat e autorizuar për çdo armë zjarri/kasafortë duhet të marrin e të përdorin çelësat;

c) Armët e zjarrit dhe municionit duhet të ruhen të ndara nga njëra-tjetra.

2. Ndërtesa ku ruhen armët e zjarrit dhe municionet duhet të pajisen me rrufepritëse, me mjete të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri.

Neni 5

Rastet e sigurisë për armët e zjarrit

Kushtet e përgjithshme për ruajtjen e armëve të zjarrit dhe municionit bazohen e variojnë sipas numrit të armëve të zjarrit të lejuara për mbajtje dhe sasinë e municionit, sipas kësaj ndarjeje:

a) një deri në dy armë zjarri;

b) tre deri pesë armë zjarri;

c) gjashtë deri pesëmbëdhjetë armë zjarri;

ç) mbi pesëmbëdhjetë armë zjarri;

- d) për subjektet e licencuara për tregtimin e armëve të kategorisë “B” e “C”;
- dh) paraqitja në panaiet për armë;
- e) për armët në muze dhe për koleksione;
- ë) prodhimi i filmave, interpretime teatrale dhe manifestime të tjera kulturore;
- f) për municionet deri në 200 fishekë;
- g) deri 5 kg barut i zi;
- gj) për municion (mbi 200 fishekë apo më shumë se 5 kg barut të zi).

Neni 6

Standardi dhe kriteri i sigurisë për armët

Standardi dhe kriteret për sigurinë e armëve përcaktohen nga numri i armëve në zotërim.

1. Rasti “Një deri në dy armë zjarri”

Armët e zjarrit ruhen nga mbajtësi i autorizuar i armëve në një objekt të mbyllur, i siguruar me kyç.

Armët sigurohet me kyç bllokimi ose kabllloja me çelës.

Çelësat mbahen nga personi i autorizuar.

2. Rasti për “Tre deri në pesë armë të zjarrit”:

a) Armët e zjarrit duhet të ruhen në kasafortën e llojit të aprovuar, me peshë deri 150 kg, e ndërtuar nga material metalik, trashësi jo nën 3 mm dhe i ndërtuar me saldim të vazhdueshëm në të gjitha skajet e jashtme;

b) Kasaforta duhet të jetë e pajisur me derë të trashësisë jo më pak se 6 mm, që rrotullohet në bosht të fshehur ose të montuara jashtë, e tillë që skajet e menteshave të salduara për derë dhe për trup të kasafortës, me hapësirë (*lluft*) rreth derës jo mbi 1 mm;

c) Kasaforta duhet të jetë e pajisur me çelës prej gjashtë levash, mekanizëm me çelës ose kyç kombinues pa çelës ose kyç që kapet me më shumë se tre mekanizma mbyllës, nëse dera e kasafortës është më e madhe se 1.3 metra në lartësi;

ç) Kasaforta duhet të jetë e kyçur gjatë gjithë kohës;

d) Kasaforta e armëve duhet siguruar e vendosur, e montuar me vida në dyshe dhe (në ose për muri) në pozicion sa më afër murit për të hequr mundësinë e hapjes ose prerjes.

3. Rasti për “Gjashtë deri në pesëmbëdhjetë armë të zjarrit”

a) Armët e zjarrit duhet të ruhen në kasafortën e llojit të aprovuar, të peshojnë së paku 500 kg;

b) Kasaforta duhet të plotësojë kriteret e nenit 6 pika 2;

c) Vendi i ruajtjes për këtë rast duhet të pajiset me sistem alarmi dhe monitorimi.

4. Rasti për “Mbi pesëmbëdhjetë armë të zjarrit”:

a) Standardi dhe kriteret e ruajtjes e të sigurisë janë të njëjta me ato të vendosura në pikën 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, të këtij neni;

b) Vendi i ruajtjes për këtë rast duhet të plotësojë, përveç kriterëve të përcaktuara më sipër në shkronjën “a” edhe pajisjen me video vizive;

c) Të gjitha dyert e perimetrit të depos duhet të jenë të ndërtimit të fortë, dhe të kapura sigurt me mentesha. Dyert e tilla duhet të pajisjen me mekanizmin me çelës;

5. Rasti për ekspozimin e armëve në “subjektin e licencuar të tregtimit të armëve”

Standardi i sigurisë së depos duhet të përmbushë:

a) Vendosjen e pajisjeve me sistem alarmi dhe monitorimi;

b) Vendosjen e pajisjeve videovizive;

c) Të gjitha dyert e perimetrit të depos duhet të jenë të ndërtimit të fortë dhe të kapura në mënyrë të sigurt me mentesha. Dyert e tilla duhet të pajisjen me mekanizmin me çelës;

c) Ekspozita e armëve të zjarrit duhet të jenë me material të fortë druri ose hekuri të mbyllur me panele qelqi jo më pak se trashësia 6 mm;

d) Ekspozita e armëve montohet në tullë, gur ose beton, duhet të ngjitet me së paku katër (4) vida;

dh) Ekspozita e armëve për ekspozim duhet të mbyllet me kyç;

e) Armët e zjarrit të ekspozuara duhet të sigurohen për të penguar marrjen e tyre me kablllo fleksibël të veshur me plastikë ose zinxhir metalik me trashësi jo më pak se 4 mm, e cila duhet të kalojë përmes mburojës së këmbëzës ose armës dhe të sigurohet për muri në të dyja skajet.

6. Rasti për ekspozimin e armëve në muze

Standardi i sigurisë së objektit muze të armëve, kur në to ruhen armë që konsiderohen të tilla në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, duhet të përmbushë:

a) vendosjen e pajisjeve me sistem alarmi dhe monitorimi;

b) vendosjen e pajisjeve videovizive;

c) Të gjitha dyert e perimetrit të depos duhet të jenë të ndërtimit të fortë dhe të kapura në mënyrë të sigurt me mentesha. Dyert e tilla duhet të pajisjen me mekanizmin me çelës;

ç) Ruajtjen e objektit me roje statike ose patrullë.

7. Rasti i sigurisë së armëve për përdorim kinematografik e skenik.

Standardi i sigurisë ku ruhen armë, që konsiderohen të tilla në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, për përdorim kinematografik e skenik, për të cilin ekzistojnë tri raste të ruajtjes së përkohshme që mund të aplikohen:

a) vendi apo dhoma e ruajtjes së përhershme;

b) kontrata e nënshkruar me personin juridik që ka vend të ruajtjes të certifikuar;

c) përdorimi i vendit të ruajtjes së përkohshme (deri 10 ditë të punës) dhe të aplikueshëm vetëm deri 15 armë të zjarrit.

Neni 7

Kushtet e përgjithshme për municion

Personat fizikë dhe juridikë, të cilët zotërojnë armë zjarri të lejuara, janë të detyruar që municionin e këtyre armëve ta ruajnë, si më poshtë:

a) çelësat e depos për municion duhet të ruhen në vend të sigurt. Ato i zotëron vetëm personi i autorizuar;

b) armët e zjarrit dhe municioni ruhen të ndara nga njëra-tjetra;

c) fishekët nuk duhet të lihen brenda karikatorit të armës së zjarrit gjatë ruajtjes.

Neni 8

Standardi dhe kriteri i sigurisë së municionit

1. Në rastin për sasinë deri në 200 fishekë për armë të zjarrit me tyta të vjaskuara:

a) municioni ruhet në depon e armatimit i ndarë nga arma;

b) municioni mund të jetë i ndarë nga kasaforta e armëve ose brenda saj në raft të veçuar;

c) kasaforta e municionit duhet të jetë prej metali të fortë. Kasaforta mbahet e mbyllur me çelës.

2. Në rastin e barutit për rimbushje deri në 5 kg (për fishekë arme gjahu):

a) baruti ruhet në kasafortë të sigurt, larg çdo mjeti që mund të shkaktojë ndezjen;

b) ambienti dhe kasaforta e vendit ku ruhet e kryhet procedura e rimbushjes së fishekëve sigurohet njëllor si depot e armëve me derë të sigurt dhe metalike.

3. Rasti mbi 200 fishekë

Kërkesat speciale të sigurisë janë të njëjta si kriteret e sigurisë për ruajtjen e mbi 15 armëve të

zjarrit, depoja kërkon sisteme alarmi dhe sistem monitorimi me kamera.

Neni 9

Distancat e sigurisë për depo municion

1. Depot e municionit duhet të sigurojnë distancë në raport me vendet e banuara për shkak të përbërjes së tij me lëndë plasëse e djegëse. Distanca llogaritet në bazë të përqendrimit të lëndës shpërthyes në sasinë e municionit.

2. Kjo tabelë cakton distancat ndarëse të depos së municionit nga zona e banuar. Distancat janë të bazuara në sasinë neto të shpërthyesit.

Tabela tregon se sa fishekë janë baras me NEQ-në në kg.

3. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët zotërojnë armë zjarri të lejuara, janë të detyruar që armën e zjarrit ta ruajnë, si më poshtë:

NEQ (kg)	Distanca në (m)	Nr. i fishekëve 9 mm Parabelium (copë)
0.1-250	0	625.000
250-300	1	625.000 - 750.000
400-450	5	1.000.000 - 1.125.000
1000-1100	16	2.500.000 - 2.750.000
1900-2000	30	4.750.000 - 5.000.000

4. Llogaritja e sasisë së eksplozivëve neto duhet të bëhet në çdo vend të ruajtjes dhe të aprovohet nga organi kompetent para se të lejohet kategorizimi i vendit të ruajtjes.

Neni 10

Inspektimi i mbajtjes dhe i ruajtjes së armëve

Në bazë të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, punonjësi i policisë i autorizuar në çdo moment, në rast dyshimi, ka të drejtë të inspektojë mbajtësit e armëve me licencë apo autorizim në banesë, në vendin e ruajtjes dhe gjatë transportit të armës së zjarrit dhe municionit.

PJESA III

KUSHTET E SIGURISË QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR VEPRIMTARINË E TRANSPORTIT TË ARMËVE, PJESËVE DHE MUNICIONEVE TË TYRE

Neni 11

Transporti i armëve

Transportin me armë, pjesë të armëve dhe municion mund ta bëjnë personat juridikë me seli në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë licencuar nga Policia e Shtetit për këtë qëllim.

Neni 12

Kushtet për kryerjen e transportit

Subjektet e licencuara për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) Të disponojnë “Certifikatën e miratimit të mjetit, sipas ADR-së”, e lëshuar nga institucionet, sipas nenit 37, të ligjit nr. 118/2012, “Për transportin e lëndëve të rrezikshme”, që vërteton se një mjet i vetëm i destinuar për transportin e disa mallrave të rrezikshme plotëson kërkesat teknike përkatëse, sipas marrëveshjes së përmendur në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji.

b) Të jenë pajisur me “Certifikatë trajnimi”, e lëshuar për personin, i cili ka kaluar një provim të miratuar nga autoriteti përgjegjës në transportin e mallrave të rrezikshme (sipas ligjit nr. 118/2012,

“Për lëndët e rrezikshme”);

c) Të disponojnë certifikatën e vlefshme të ADR-së të drejtuesit të mjetit që do të kryejë transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve (sipas ligjit nr. 118/2012, “Për lëndët e rrezikshme”);

ç) Të disponojë certifikatën e aftësisë profesionale të vlefshme të drejtuesit të mjetit për kategorinë e mjetit me të cilin do të kryhet transporti i armëve, pjesëve dhe municioneve;

d) Pajisjen e automjetit me GPS-në funksional për kontrollin dhe dokumentimin e itinerarit në subjektin që bën transportin.

Neni 13

Rregullat dhe kushtet teknike që duhet të plotësojë automjeti për transportin e armatimit dhe municionit

1. Automjeti dhe drejtuesi i mjetit që kryejnë transport armatimi e municioni dhe pjesë këmbimi për armët duhet të jetë me ADR (e licencuar, e kompletuar teknikisht dhe e sigurt fizikisht).

2. Automjeti gjatë transportimit të armatimit e municionit të jetë i pajisur me tabelën për shkallën e rrezikshmërisë.

3. Automjeti duhet të jetë i kompletuar me fikse zjarri, e mbuluar dhe me skapamento me fikse shkëndije zjarri.

4. Municioni duhet të jetë i sistemuar i lidhur ndërmjet tyre i ambalazhuar.

5. Në rastet kur automjeti që transporton armatim e municion është me sponde, ndalohet vendosja e arkave të armatimit, pjesëve të ndërrimit dhe municionit më lart se spondet e makinës.

6. Ndalohet transporti i armatimit, municionit dhe pjesëve të këmbimit të armëve në automjete me pasagjerë.

7. Nëse për transport armatimi e municioni përdoren më shumë se dy automjete, duhet të bëhet shoqërimi me eskortë të SHPSF-së.

Neni 14

Ndalime

Gjatë transportit të municioneve ndalohet:

a) të bëhet furnizimi me karburant i automjetit ose të nxirret karburant nga serbatori;

b) të transportohen së bashku me municionin karburant, vajëra, graso, përbërës kimikë ose substanca e materiale që janë lehtësisht të djeg-shme;

c) qëndrimi i automjeteve të ngarkuara me municion në qendrat e banuara.

PJESA IV

LICENCA PËR POLIGONET CIVILE TË QITJES

Neni 15

Poligonet civile të qitjes

Poligonet e qitjes janë:

a) poligon qitjeje i mbyllur (të mbuluar);

b) poligon qitjeje i hapur (në terren, të pambuluar);

a.1. poligon qitjeje i mbyllur është objekt (ndërtesë), i ndërtuar mbi bazën e një projekti me

material të veçantë dhe i kompletuar me pajisje specifike për trajnimin dhe zhvillimin e qitjeve me armë zjarri;

b.1. poligon qitje i hapur është pjesë terreni (territori) e përzgjedhur dhe e përgatitur sipas kritereve standarde për trajnimin e zhvillimin e qitjeve me armët e zjarrit.

Neni 16

Rregullat e ndërtimit dhe shfrytëzimit të poligoneve të hapura

Poligoni i ndërtuar në natyrë duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të jetë larg qendrave të banuara dhe drejtimi i zjarrit të jetë në drejtim të kundërt me banesat;
b) Në drejtim të qitjes, poligoni sigurohet në më shumë se tre kilometra në vijë ajrore dhe po aq në të dy krahët në këndin 90 gradë me drejtimin e qitjes;

c) Strehimi duhet të jetë 2.2 metër i thellë, duke filluar nga sipërfaqja e tokës dhe 1.5 metër i gjerë, ndërsa gjatësia është në varësi të madhësisë së shenjave që do të vendoset. Muret vishen me gurë ose tulla. Ana e strehimit nga bëhet qitja duhet të jetë më e lartë, e mbuluar me element betoni dhe sipër me plisa dheu, pjesa e prapme duhet të jetë me dhe të shkrifët dhe të mos ketë objekt të fortë që mundëson rikoshetimin e plumbave;

ç) Kur tabelat shfaqen me anë mekanike (mekanizëm me litar e kavo) dhe tërhiqen nga mbajtësi i tabelave, prej tij mbahet skafandër antiplumb dhe qëndron në fund të strehimit në drejtim të qitjes.

Neni 17

Rregullat e ndërtimit dhe shfrytëzimit të poligoneve të mbyllura

1. Kërkesat teknike të poligonit të mbyllur.

a) Sipërfaqja e poligonit:

Jo më pak se 500 m² për zhvillimin e qitjeve me pistoleta të kalibrit 9 mm, fishek të 9x19/9x21 mm dhe në një largësi prej 25 metrash.

b) Ndarjet e ambienteve në poligonet e qitjes.

Çdo poligon ka:

- dhomën e regjistrimit të mbrojtur me xham antiplumb;
- dhomën e komandës nga e cila monitorohen veprimet gjatë zhvillimit të qitjes, dy ndarje me nga tre korsi qitjeje.

c) Pajisjet mbrojtëse të poligonit të qitjes.

Çdo poligon qitjeje siguron:

- mbrojtje akustike, realizuar me një veshje;
- mbrojtje për uljen e shpejtësisë së plumbave, realizuar me një veshje me material të përshtatshëm gome, sintetike;

- mbrojtje nga gazrat helmuese, ku evitohen gazrat e çliruara gjatë zhvillimit të qitjes, janë vendosur pajisje të ndërrimit të ajrit të ndotur.

Neni 18

Klasa mësimore dhe dhomat e ruajtjes së armatimit e municionit

Në poligon janë:

a) klasa mësimore me një kapacitet deri 25 pjesëmarrësish;

b) dhoma e ruajtjes së armatimit e municionit.

Neni 19

Materialet e ndërtimit të poligoneve të qitjes, përbërja dhe cilësitë teknike të tyre

1. Cilësitë teknike të ndërtimit të poligoneve duhet të sigurojnë:

a) për mbrojtje nga qitjet e pavullnetshme:

- i) poligonet e qitjes vishen me pllakë gome regupol E 22 mm dhe E 43 mm e trashësi 50 dhe 20 mm;
- ii) pjesa balllore dhe tavanet e sallave të qitjes vishen me pllakë metalike me trashësi 5 mm;
- iii) muret anësore të sallave të qitjeve vishen me profil hekuri me trashësi 1 mm;
- iv) muratura e sallave të qitjeve duhet të jenë me densitet të lartë 7x12x25 cm.

b) Për mbrojtje nga zhurmat:

Poligonet e qitjeve vishen me një nga këto materiale:

- i) me pllakë AMF^F fibër minerale;
- ii) me pllakë druri;
- iii) me lesh xhami mineral;
- iv) me pllakë industriale akustike.

c) Për mbrojtje nga zjarret:

Poligonet e qitjeve:

- i) lyhen me bojë kundër zjarrit;
- ii) vendosen dyer e dritare kundër zjarrit;
- iii) vendosen detektor tymi dhe central alarmi për paralajmërimin e zjarrit;

iv) bëhet veshja me tullë zjarrruduese dhe me densitet të lartë në muret ndarëse dhe rrethuese të sallave të qitjes.

Neni 20

Pajisjet specifike në poligonin e qitjes

Në poligonin e qitjes instalohen dhe disa pajisje specifike:

1. Pajisje për ventilim

Sallat e qitjes pajisen me sistem ventilimi, ajrimi dhe kondicionimi.

2. Pajisje për komandim gjatë zhvillimit të qitjes

Për çdo sallë qitje pajisen me një vend komandimi të pajisur me foni për komandimin dhe instruktimin e pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të qitjes.

3. Mjete sinjalistike

Pranë vendit të vendosjes së shenjave ka mjete sinjalizimi për zhvillimin e procesit të qitjes me modelin tringjyrësh:

- a) portokalli (gati për qitje);
- b) jeshile (zjarr);
- c) E kuqe (ndalo zjarrin).

4. Balli i poligonit ndërtohet në mënyrë të tillë:

- a) Të pengojë daljen e plumbit nga poligoni nën këndin 60 gradë;
- b) Ndërtohet një brez me material pengues me trashësi jo më pak se 30 centimetra, i pasuar me një hapësirë jo më pak se 30 cm i mbushur me dhe të shkriftë ose rërë, pastaj të jetë muri me tulla një hapësirë prej 1 metër dhe pas gjithë këtyre të vijë muri i ndërtesës.

5. Sinjalistika në poligone

Në poligone (i hapur ose i mbyllur) përcaktohen me tabela me shkrim të qartë dhe të kuptueshëm:

- a) baza e nisjes;
- b) vijat e zjarrit;
- c) vendi ku qëndron efektiv gjatë zhvillimit të qitjes;
- ç) vendi i furnizimit me municion;
- d) vendi i mjekimit;
- dh) vendi i pastrimit të armatimit;

e) vendrojet dhe vendvrojtimet.

Neni 21

Rregullorja tip e poligoneve

Rregullat e sigurimit teknik gjatë qitjes në poligone, detyrat e personelit të sigurimit të poligonit, detyrat e personelit që zhvillon qitjen si dhe dokumentacioni për poligonin përcaktohen në rregulloren tip të poligoneve, miratuar me akt të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

PJESA V

KUSHTET E SIGURISË SË OBJEKTIT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SUBJEKTIT TË TREGTIMIT TË ARMËVE

Neni 22

Kushtet e sigurisë së ndërtimit të objektit

1. Për ndërtimin dhe vënien në funksionim të objekteve që shërbejnë si vende për tregtimin e armëve duhet të plotësohen kushtet e sigurisë:

- a) objekti të jetë ndërtuar me material tulle ose gurë me llaç;
- b) të gjitha dyert dhe dritaret përgjatë perimetrit të depos të jenë me material të fortë dhe sigurohen me qepena ose skara metalike të mbërthyer fort në mur;

2. Kushtet dhe kriteret e sigurisë së armëve, objekt i veprimtarisë tregtare, janë ato të parashikuara në pjesën II, të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Kushtet e sigurisë brenda objektit

Objekti që shërben për tregtimin e armëve nga brenda duhet të pajiset me:

- a) kasaforta të sigurta sipas sasisë së armëve si në rastet e përcaktuara në këtë rregullore për armët e kategorisë “B”;
- b) ambient për municionin, i ndarë nga ai i armëve të tjera;
- c) dollapë ose ekspozita për armët me elemente sigurie të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 24

Kushtet e sigurisë jashtë objektit

1. Siguria e jashtme e objektit të bëhet me pajisje sistem alarmi dhe pajisje vëzhgimi vizive, si dhe me roje të shërbimit privat të sigurisë fizike. Objekti të jetë i siguruar me ndriçim të plotë nga jashtë.

2. Pajisja me sistem alarmi plotëson kërkesat e mëposhtme, si të ketë:

- a) sirenë të jashtme prej jo më pak se 100 db dhe dritë alarmi;
- b) kodin e vendosur dhe funksionet e zhurmës (përfshirë kontrollet nga larg);
- c) panelin e kontrollit me bateri mbështetëse;
- ç) ndërprerësin e derës;
- d) funksionimin e linjave prerëse ose të ngjashme që vënë në funksion sistemin nëse linja telefonike nuk funksionon;
- dh) komponentët e pajisur me ndërprerës antingacmues;
- e) regjistrin e të gjitha ndodhjeve (jo më pak se 20 ndodhi);
- ë) monitorim të zonës së programueshme (tërë ndërtesa / rezidenca);
- f) jo më pak se tre (3) detektorë të lëvizjes;
- g) ndezësin e vetëm për zone;
- gj) monitorim 24-orësh nga jashtë;

- h) tastierën për hyrje me kod dhe funksione alarmi (përfshirë kontrollet nga jashtë);
- i) panelin e kontrollit me bateri mbështetëse;
- j) ndërprerësin e derës.

3. Pajisje vëzhgimi vizive e cila plotëson këto kërkesa:

Objekti duhet të mbrohet me sistemin e vëzhgimit video. Sistemi i vëzhgimit video duhet të përmbajë këto veti:

- a) duhet të jetë CCTV ose DVR;
- b) të zotërojë mjaft kamera për të monitoruar të gjitha pikat e jashtme të pamjes së objektit dhe të gjitha muret e jashtme rreth dritareve;
- c) kamerat duhet të kenë kapacitetin infrared (infra të kuq) ose të mbështetet si alternativë përmes sensorëve të lëvizjes me dritë;
- ç) duhet të jetë në gjendje që të regjistrojë në formatin 24 orë;
- d) duhet të jetë e lidhur me pajisjen regjistruese pa marrë parasysh a është DVR, kompjuter ose videorekorder;
- dh) çdo kamerë duhet të ketë furnizimin e pavarur me energji elektrike.

Neni 25

Administrimi, monitorimi dhe regjistrimi i ngjarjeve

1. Çdo objekt që realizon shitjen e armëve, gjithashtu, duhet:
 - a) të ketë regjistrin e ngjarjeve në objekt;
 - b) të monitorohet zona e programueshme (tërë ndërtesa/rezidenca);
 - c) të ketë monitorim 24-orësh nga jashtë vendndodhjes.
2. Kopjet e kasetave të vëzhgimit/regjistrimet duhet të ruhen për jo më pak se 14 ditë.

Neni 26

Dispozita të fundit

1. Rregullorja është e detyrueshme për gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që ndodhen në territorin e Shqipërisë, si dhe subjektet e licen-cuara për veprimtari me armët.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit, të kërkojë e të mbi-këqyrë zbatimin e rregullave e të procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.